

# STATUTI I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KPT" shpk

Bazuar ne ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuar

Ne kete statut:

- "Ligji" eshte Ligji nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar
- "Statut" eshte statuti i shoqerise

## KREU I: ORTAKET, EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA

Dt. 18 shkurt 2015

### NENI 1 Ortaket themelues

Shoqeria me pergjegjesi to kufizuar "KPT" sh.p.k, krijohet nga ortaket themelues si me poshte:

- Ortaku themelues Laert Duraj, i biri i Seitit, lindur me 10/11/1972, ne Tepelene, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit numer H21110030Q;
- Ortaku themelues Korab Aliko, i biri i Paqorit, lindur me 17/9/1982, ne Gjirokaster, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit numer I20917030F;
- Ortaku themelues Hysen Xhura, i biri i Ismailit, lindur me 13/2/1972, ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me numer personal H20213063I;
- Ortaku themelues Klarita Jaupi, e bija e Jorgjit, lindur me 20/8/1976, ne Kavaje, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajttese e kartes se identitetit numer H65820068A;
- Ortaku themelues Rudin Dura, i biri i Seitit, lindur me 22/05/1977, ne Dames, Tepelene, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit numer H70522146O;
- Ortaku themelues Diana Biba, e bija e Kozmait, lindur me 24/5/1980, ne Elbasan, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajttese e kartes se identitetit numer I05524011H;

### NENI 2 Emertimi dhe Forma Ligjore

2.1 Shoqeria tregtare eshte shoqeri vendase dhe emertohet "KPT" shpk, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e shoqerise.

### 2.2 Forma ligjore

Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.), ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblese se Ortakeve sipas parashikimeve ligjore te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

### NENI 3 Selia e shoqerise

Selia e shoqerise shoqerise eshte ne adresen: Kompleksi Xhura, rruga "Xhanfize Keko", Pasuria nr.5/200, e ndodhur ne zonen kadastrale 8130, Tirane, Shqiperi".

Shoqeria ka te drejte te krijojë dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj. Me vendim të Asamblese se Ortakeve, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj. Njesite e tjera strukturore të shoqerise si dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

Laert Duraj / Rudin Dura / Klarita Jaupi / Hysen Xhura  
Korab Aliko / Diana Biba  
DIANA BIBA

#### **NENI 4 Objekti i shoqerise**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise te saj:

Te kryeje dhe te marre pjese ne te gjitha aktivitetet dhe bizneset qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje ne baze te legjislacionit shqiptar per ngritjen, funksionimin e operimin e institucioneve te arsimit te larte jopublik, te ciklit te studimeve jouniversitare te arsimit profesional dhe/ose te ciklit universitar, qe perfshijne po nuk kufizohet vetem te kolegjet profesionale, etj;

Te ngreje, vere ne funksionim dhe te operoje institucione te arsimit te larte jouniversitare, jopublik, në fusha të ndryshme të arsimit profesional jouniversitar, për përgatitjen e specialistëve me orientim praktik; te ofroje programe studimi deri ne dy vjet pas arsimit te mesem, kualifikim per manaxhere te rinj dhe teknike te larte deri ne dy vjet pas arsimit te mesem;

Te ofroje veprimtari mësimore dhe trajnuese në fusha të ndryshme të arsimit profesional universitar dhe/ose jouniversitar, për përgatitjen e specialistëve me orientim praktik.

Organizimin, ofrimin e programeve, kurseve te formimit profesional, kurseve dhe trajnimeve;

Perkthimin, pergatitjen per botim, botimin, shitjen e gazetave, revistave, librave artistike, shkollore, historike, tekniko – shkencore, fjalore, tekste shkollore, botim dhe tregtim shtypshkrimesh.

Te kryeje aktivitete botuese dhe/ose reklamuese;

Shoqeria do te zhvilloje cdo veprimtari ekonomike te ligjshme sipas licenses se dhene nga organet kompetente si dhe cdo veprimtari tjetere ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Shoqeria do te respektoje te gjitha ligjet dhe rregulloret qe kane te bejne me aktivitetin e saj. Kjo nenkupton praktikant me te mira te etikes.

Per te realizuar qellimet e saj Shoqeria do te bashkepusoje me persona fizike dhe /ose juridike, vendas ose te huaj.

Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese te Ortakeve.

#### **NENI 5 Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise është e pakufizuar.

#### **NENI 6 Kapitali**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e meposhtme:

- Ortaku themelues Laert Duraj: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 30 000 leke qe perben 30 % te kapitalit themeltar te shoqerise;
- Ortaku themelues Korab Aliko: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 20 000 leke qe perben 20 % te kapitalit themeltar te shoqerise;
- Ortaku themelues Hysen Xhura: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 20 000 leke qe perben 20 % te kapitalit themeltar te shoqerise;
- Ortaku themelues Klarita Jaupi: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 20 000 leke qe perben 20 % te kapitalit themeltar te shoqerise;
- Ortaku themelues Rudin Dura: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 5 000 leke qe perben 5% te kapitalit themeltar te shoqerise;
- Ortaku themelues Diana Biba: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 5 000 leke qe perben 5 % te kapitalit themeltar te shoqerise;

*Laert Duraj* *Rudin Dura* *Klarita Jaupi* *Hysen Xhura*  
*Diana Biba* *Korab Aliko* *Jaupi*  
*2*

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e Statutit të saj.

### KREU II KUSHTET EKONOMIKE

#### NENI 8

Shoqëria cel llogari bankare në monedhen vendase dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

#### NENI 9

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil. Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën 50% të pjesëve të kapitalit themeltar dhe në përputhje me nenin 10.

#### NENI 10

##### E drejta e parablerjes

Transferimi për çdo arsye, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër, i cili mund të ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomandë, i cili përmban cmimin, blerësin e mundshëm dhe mënyrën e pagimit.

Në rast se ortakët nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se ka hequr dorë prej të drejtës së parablerjes dhe pjesët e kapitalit.

Në rastin e mosushtimit të së drejtës së parablerjes nga ortakët, Ortakët që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të ofruara ortakut tjetër të shoqërisë.

#### NENI 11

Me vendim të ortakëve të shoqërisë, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtime të tjera të cilat janë me interes për mbarevajtjen e shoqërisë.

### KREU III

### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

#### NENI 12

Asambleja e përgjithshme është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimmarres i shoqërisë dhe ajo ushtron të gjitha kompetencat që i njeh ligji "Për shoqëritë tregtare".

Asambleja e përgjithshme mund t'ia delegojë kompetencat administratorit të caktuar prej saj sipas parashikimeve në Statut.

#### NENI 13

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator i Vetëm.

Administratori i shoqërisë "KPT" sh.p.k. është Z. Laert Duraj, shtetas Shqiptarë, i biri i Seitit, lindur në Tepelenë, më 10/11/1972, banues në Tiranë, mbajtes i Letërnjoftimit numer H21110030Q, me një afat emerim 5 (pese) vjeçar.

Laert Duraj  
Ludim Duraj  
Korab Aliu  
Klodian Gjergji  
Aljoza Haxhiu

Mirza Duraj  
3  
BIRNA BISA  
Ro. P. K.

Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumice të thjeshtë.

Administratori qendron në detyrë deri në revokimin e mandatit të tij nga Asambleja.

Administratori mban individualisht përgjegjësi përballë shoqërisë ose të tretteve për shkeljet e mundshme të ligjit dhe/ose të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Administratori mund të zevendesohet në çdo moment me vendim të autoriteteve gjyqësore shqiptare për shkelje të ligjit.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhëniet me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua njeh shprehimisht ortakeve. Përfaqësimi i shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet si brenda dhe jashtë shtetit si rregull i përgjithshëm i përket Administratorit të shoqërisë.

Administratori:

- i. kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- ii. përfaqëson shoqërinë tregtare;
- iii. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- iv. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- v. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- vi. kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- vii. raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- viii. kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Paga e administratorit përcaktohet me vendim të Asamblese së Ortakeve.

#### NENI 14

##### Thirrja dhe zhvillimi i mbledhjeve

Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë në territorin e Republikës së Shqipërisë por mund të zhvillohen dhe jashtë selisë.

Njoftimi (lajmerimi) kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomandë, poste elektronike (e-mail) ose poste tjetër të regjistruar, jo më vonë se 7 dite përpara datës së zhvillimit të mbledhjes. Lajmerimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Lajmerimi bëhet nga administratori i shoqërisë.

#### NENI 15

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesit, dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

*Racit Jure*  
*Luca*  
*Klorita Jure*  
*DIANA BIGA*  
*Alina Bilo*  
*Alina Bilo*  
*MUSEY XHORA*  
*Korab Aliko*

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë ka edhe keto të drejta dhe detyra kryesore:

Të marrë pjesë në drejtimin dhe administrimin e gjithanshem të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë dhe të cdo veprimtarie tjetër të saj, kur ajo ushtrohet në përputhje me Ligjet, dhe Statutin e saj.

Të kërkojë dhe t'i japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarisë së shoqërisë, si dhe i të gjitha dokumentave të perpunuara nga shoqëria;

Në rast vendimesh të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët zotërues të më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kuotave. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së Kuorumit në thirrjen e parë, Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet perseri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) dite nga thirrja e parë. Në rast vendimesh të zakonshme, keto të fundit merren me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm apo të perfaqësuar.

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të zakonshme për çështjet e mëposhteme:

- (a) Përcaktimin e politikave tregtare;
- (b) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit, eksperteve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve;
- (c) Miratimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikën b);
- (d) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- (e) Perfaqësimin e Shoqërisë në gjykate dhe në procese të tjera ndaj Administrimit dhe/ose Administratorit;
- (f) Çdo çështje tjetër të përcaktuar nga Ligji apo Statuti.

#### **Vendime të jashtëzakonshme**

Në rast vendimesh të jashtëzakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm aksionaret zotërues të më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të ortakëve me të drejtë vote. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së Kuorumit në thirrjen e parë, Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet perseri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) dite nga thirrja e parë. Në rast vendimesh të jashtëzakonshme, keto të fundit merren me votën pro të  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm apo të perfaqësuar.

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të jashtëzakonshme për çështjet e mëposhteme:

- (a) Ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
- (b) Zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit;
- (c) Shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- (d) Riorganizimin, shpërndarjen, shndërrimin, bashkimin, shkërrimin, ndarjen, prishjen apo likuidimin e Shoqërisë, ose riorganizimin e Shoqërisë në një formë tjetër;
- (e) Cdo çështje tjetër të përcaktuar nga Ligji apo Statuti.

#### **NENI 16**

Asambleja e Ortakëve dhe administratori i shoqërisë, ka të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqërisë, të marrin në punë shtetas të ndryshëm, duke lidhur kontrata sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi si dhe në përputhje me rregullat e brendshme të disiplinës teknike dhe të punës të caktuara nga vete Shoqëria. Kontrata të tilla do të nënshkruhen nga Administratori.

*Handwritten signatures and names:*  
Dimitër Jany, Qudim Jus, Klavitor Jany, Myseu Xurza, Diana Bida, Kores Helco, and other illegible signatures.

## KREU IV BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

### NENI 17

Viti fiskal fillon ne 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor te cdo viti.

Per nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqerise, mbi bazen e aktivitet dhe pasivit, ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve nje ekspert kontabel i autorizuar.

### NENI 18

#### **Ekspertet kontabel te autorizuar**

Auditimi i brendshem i Shoqerise do te behet nga eksperte kontabel te autorizuar, te caktuar per nje vit fiskal. Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen nga Asambleja e Pergjithshme me vendim te zakonshem.

### NENI 19

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bere me saktesi dhe duke respektuar të gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, qe jane të detyrueshme per t'u zbatuar nga cdo subjekt privat, qe ushtron veprimtari tregtare.

Kontabiliteti mbahet ne gjuhen Shqipe, ne monedhen Shqiptare dhe pasqyrohet ne librat perkates. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute. Shoqeria mund te marre financime nga ortaket, institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Ortakeve.

### NENI 20

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaket, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

### NENI 21

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Asambleja percakton pjesen qe iu takon ortakeve ne forme dividendesh.

### NENI 22

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

- me vendim te Asamblese se pergjithshme
- Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- me hapje e procedurave te falimentimit
- Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

### NENI 23

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrit Tregtar.

*Roert Jung*

*Suedim Duru*

*Klarita Terapi*

*Stjepan*

*HUSEN XHARRA*

*Korab Aliko*

*DIANA BOZA  
Fiona Pasha*

**NENI 24**

Cdo mosmarreveshje apo konflikt qe mund të linde gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne te kunderten, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

**NENI 25**

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, do te rregullohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe udhezimet plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga Asambleja e Pergjithshme.


**NENI 26**

Ky statut u redaktua ne 7 origjinale ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlere te njejte juridike.


**THEMELUES TE SHOQERISE  
"KPT" sh.p.k.**

**ORTAKET THEMELUES**


Laert Duraj




Korab Aliko




Hysen Xhura



Klarita Jaupi



Rudin Dura



Diana Biba

